

Agjencia realizoi mbikëqyrje të jashtëzakonshme të operatorit kabllor MULTIMEDIJA-NET

Shkup, 27.07.2017 – Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale realizoi mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore ndaj operatorit kabllor MULTIMEDIJA – NET SHPK Shkup, lidhur me disa obligime ligjore – ritransmetimin e shërbimeve programore me pornografi vetëm në formë të koduar, titrimin të gjuhës maqedonase ose gjuhës së bashkësisë që nuk është shumicë në RM, regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci si dhe ritransmetimin e shërbimeve programore vetëm në zonën e shërbimit për të cilën radiodifuzerët kanë leje për sigurim të emetimit të TV ose radios.

Agjencia konstatoi se operatori kabllor për shfrytëzuesit e tyre i ka ritransmetuar shërbimet programore Cartoon Network dhe Boomerang, që nuk janë të përfshira me vërtetimet për regjistrimin e shërbimeve programore të lëshuara nga Agjencia.

Raporti nga mbikëqyrja e realizuar mund të merret në linkun: [MULTIMEDIA – NET SHPK Shkup](#).